

VENDIM
Nr. 20, datë 26.1.2026

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË 8.11.2017,
“MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË ‘OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR’
ALBGAS SHA”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 53, pikat 2 dhe 3; dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 258 prot., datë 19.1.2026, të për gatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, ‘Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror, Albga sh.a.’”, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, Bordi i ERE-s certifikoi shoqërinë “Albga sh.a. si “Operator i Kombinuar i Gazit Natyror”, duke vendosur në pikën 5.2 detyrimin për bashkëpunim ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në nenin 11 dhe nenin 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe transferimin e kompetencave përkatëse, për të cilat shoqëria duhet të paraqesë në ERE provat dokumentare të realizimit të tyre.

- Në vijim, për shkak se realizimi i këtij kushti nuk varej nga veprimet e njëanshme të shoqërisë “Albga sh.a., pasi lidhej me ndërhyrje në kuadrin ligjor primar dhe me procese vendimmarrëse ndërinstitucionale, Bordi i ERE-s, me vendimet nr. 59, datë 2.4.2024, dhe nr. 272, datë 10.12.2024, vendosi të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, i ndryshuar, duke i lënë kushtin shoqërisë “Albga sh.a. që brenda datës 31.12.2025 të depozitojë në ERE dokumentacionit përkatës.

- Shoqëria “Albga sh.a., me shkresën nr. 127, datë 19.12.2025, ka kërkuar shtyrjen e afatit për përmbushjen e kushtit të certifikimit si “Operator i Kombinuar i Gazit Natyror” deri më 31.12.2026, duke bërë të ditur se vendimi përfundimtar nga ministria ende nuk është miratuar. Për këtë arsye, përmbushja e kushtit brenda afatit aktual rezulton objektivisht e pamundur për shoqërinë për shkaqe jashtë vullnetit të saj.

- Duke u bazuar në sa më sipër dhe informacionin e bërë të ditur nga shoqëria, vlerësohet e arsyeshme të merret në konsideratë kërkesa e shoqërisë për shtyrjen e afatit për përmbushjen e kushtit të vendosur në pikën 5.2, të vendimit nr. 179/2017, i ndryshuar, pasi realizimi i këtij kushti lidhet me procese ndërinstitucionale dhe legjislative, të cilat nuk varen nga veprimet e drejtpërdrejta të shoqërisë.

- Në këto rrethana, vlerësohet se lidhja e këtij detyrimi me një afat kalendarik ka rezultuar joefektive, për shkak se realizimi i tij është i kushtëzuar nga zhvillime objektive në kuadrin ligjor dhe institucional të sektorit të gazit natyror. Për rrjedhojë, për të ruajtur koherencën rregullatore dhe për të mos e kthyer kushtin në një detyrim formal të pazbatueshëm, vlerësohet e arsyeshme që përmbushja e tij të lidhet me momentin e bërjes efektive të tregut të gazit natyror, si fazë kur struktura institucionale dhe ndarja e kompetencave marrin formë përfundimtare.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: “Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.”.

- Gjithashtu, në nenin 53, pika 3, të këtij ligji parashikohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

- Duke qenë se afati për përmbushjen e detyrimit në fjalë është caktuar me vendim të Bordit të ERE-s, si dhe duke marrë parasysh se pala e interesuar ka paraqitur kërkesë të justifikuar përpara përfundimit të

afatit, ndërkohë që mosrealizimi i detyrimit lidhet me shkaqe objektive, jashtë vullnetit të saj, vlerësohet se shtyrja e mëtejshme e afatit është e justifikuar dhe në përputhje me nenin 53, pikat 2 dhe 3, të KPA-së.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, i ndryshuar, si më poshtë:

a) Pika 5.2 bëhet si vijon:

“5.2 Deri në bërjen operativ të tregut të gazit natyror, shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të depozitojë transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave.”;

b) Pas pikës 5.2. shtohet pika 5.2.1 si më poshtë:

“5.2.1 Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të raportojë dhe të dokumentojë pranë ERE-s, brenda vitit 2026, hapat e ndërmarrë dhe statusin e procedurave për realizimin e ndryshimeve të sipërcituara, duke paraqitur informacionin dhe dokumentacionin përkatës mbështetës për realizimin e ndryshimeve në nenin 11 dhe nenin 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti